



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 282, Datë 18.12.2024

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “MET ALBANIA” SH.A. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2498/1 prot., datë 17.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “MET Albania” sh.a. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “MET ALBANIA” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2498 prot., datë 05.12.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “c”; për pikën 1.3, gërmat “a” dhe “c”, dhe për pikën 2.4, gërmën “c”.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria duhet të plotësojë më tej dokumentacionin në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të dokumentojë mbështetjen financiare të mjaftueshme, duke bërë shpërndarjen për secilën veprimtari, duke qenë se paralelisht ka aplikuar dhe për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë.

Pika 2.4. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të informojë se si ka parashikuar të sigurojë shërbimin e IT për 6 mujorin e parë të vitit 2025.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të informojë se kur do t’i disponojë zyrat përfaqësuese të furnizuesit.
- **gërma “d”**: Shoqëria duhet të japë informacion mbi mënyrën e realizimit të matjes së energjisë për klientët.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “MET Albania” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “MET Albania” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI